



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 883/5 prot.

Datë 02/06/2023

V E N D I M
Nr. 461/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02/06/2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*OLSI*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-63921-03-28-2023, me objekt: “*Blerje gazoil*”, me fond limit 9.815.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A.

Ankimues: “*OLSI*” SHPK
Adresa: Fshati Grize. Rruga Fier-Patos, Banesa në KM 6 (*OLSI SHPK*), Patos, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A
Adresa: Rajoni Nr. 1, Rruga “*Boris Plumbi*”, Nr. 20 Korçë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e*

Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.03.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-63921-03-28-2023, me objekt: “Blerje gazoil”, me fond limit 9.815.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A.

II.2. Më datë 11.04.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 14.04.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “OLSI” SHPK

16.2 lekë/litër

skualifikuar

II.4. Në datën 14.04.2023, operatori ekonomik “*OLSI*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“- Lidhur me operatorin ekonomik “*OLSI*” Sh.p.k, mbështetur në nenin 92, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si dhe në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, nenin 82, vendos që ofertuesi “*OLSI*” Sh.p.k të moskualifikohet sepse : Oferta e “*OLSI*” Sh.p.k me marzh fitimi 16,2 lekë/litër është në kundërshtim me nenin 2 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar” , i cili përcakton marzhin e tregtimit me pakicë : 12 lekë/ litër. Referuar nenit 4 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, si dhe Njoftimit të APP-së nr. 2060, datë 23.03.2022 , si anëtar i KVO-së mbaj në konsideratë parashikimet e Ligjit Nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar dhe për shkak se marzhi i fitimit i ofuar është më i lartë se kufiri 12 lekë/ litër vendos që të mos pranoj ofertën e “*OLSI*” Sh.p.k.”.

II.5. Në datën 25.04.2023 është publikuar Njoftim i Anulimit të procedurës objekt-prokurimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 25.04.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 883 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3053, e operatorit ekonomik “*OLSI*” SHPK, pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-63921-03-28-2023, me objekt: “*Blerje gazoil*”, me fond limit 9.815.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 883/2 prot, datë 26.04.2023.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 142/16 prot., datë 08.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 883/3 prot., datë 11.05.2023, me objekt “*Njoftim për veprimin e komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës për korrigjimin e të metave të ankesës të “OLSI” Sh.p.k*”, ku njoftohet Komisioni i Prokurimit Publik se me anë të postës elektronike i është kërkuar operatorit ekonomik ankimues që të paraqesë brenda dy ditëve pranë autoritetit kontraktor dokumentin bankar të pagesës së tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.9. Njëpërmjet shkresës nr. 142/20 prot., datë 09.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 883/4 prot., datë 11.05.2023, me objekt “Dërgim i vendimit për ankesën e “OLSI” Sh.p.k dhe dokumentacionin shoqëruar”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi nr. “142/18 prot, datë 09.05.2023, i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me shqyrtimin e ankesës së shoqërisë “OLSI” SHPK, ku është vendosur mospranimi i ankesës, ku ndër të tjera, citohet: “Pasi shqyrtuam ankesën e paraqitur, dokumentet e paraqitura nga ofertuesi, vlerësimin KVO-së, duke vepruar në sistemin elektronik të prokurimit, konstatojmë dhe arsyetojmë sa më poshtë vijon:

1. KVO me Vendimin Nr. 142/11 prot, datë 13.04.2023, të vlerësimin të skualifikimit të "OLSI" Sh.p.k dhe anulimit të procedurës së prokurimit, ka vendosur si më poshtë:

"Për operatorin ekonomik "OLSI" Sh.p.k, KVO vendosi në mënyrë unanime sa më poshtë vijon:

Procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, REF-63921-03 -28-2023, me objekt “Blerje gazoil” dhe fond limit 9.815.000 (nëntë milion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH anulohet sepse nuk u dorëzua asnjë ofertë e përshtatshme.

KVO vendosi që operatorin ekonomik i vetëm i paraqitur "OLSI" Sh.p.k, të moskualifikohej sepse oferta e "OLSI" Sh.p.k me marzh fitimi 16,2 lekë/litër është në kundërshtim me nenin 2 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, i cili përcakton marzhin e tregtimit me pakicë 12 lekë/litër.

Referuar nenit 4 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, si dhe Njoftimit të APP-së nr. 2060, datë 23.03.2022, KVO ka mbajtur në konsideratë parashikimet e Ligjit Nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar dhe për shkak se marzhi i fitimit i ofuar është më i lartë se kufiri 12 lekë/litër ka vendosur që të mos e pranojë ofertën e "OLSI" Shpk.

KVO ka marrë vendim Nr, 142/11 prot, datë 13.04.2023 ka skualifikuar “OLSI” Sh.p.k në SPE dhe ka anuluar procedurën e prokurimit.

2. Ankuesi në ankesën e tij pretendon, citojmë:

Operatori ekonomik "OLSI" Shpk, deklaron se Autoriteti Kontraktor përcakton dhënien e një kontrate duke bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme që bazohet në çmimin më të ulët i cili zërthehet në disa elementë siç janë: çmimi bursës, elementët fiskalë dhe norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute. Duke ju referuar skualifikimit të ofertës operatori pretendon se arsyeja e skualifikimit për marzhin e flimit që është më i lartë se 12 lekë/litër nuk qëndron, pasi Autoriteti Kontraktor në vlerësimin e një procedure prokurimi duhet ti referohet vetëm ligjit 162

datë 23.12.2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në lidhje me arsyen se marzhi i fitimit 16,2 lekë/litër është në kundërshtim me nenin 2 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, operatori pretendon se edhe ky qëndrim i Autoritetit Kontraktor nuk qëndron, pasi edhe në këtë rast duhet ti referohej legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Operatori ekonomik pretendon se duke qënë se aktet normative Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe Akti Normativ Nr.5 datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999” rregullojnë një situatë të veçantë që ka të bëjë me çmimin e tregëtimit me shumicë/pakicë të nëprodukteve të Naftës dhe Gazoil (Bordi), operatori sjell në vëmendje ndryshimet e bëra nga Gjykata Kushtetuese e cila ka vendosur shfuqizimin e ligjit Nr. 44/2022 “Për Miratimin e Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar. Pra si përfundim operatori ekonomik pretendon se me këtë vendim Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka shfuqizuar Bordin e Transparencës.

Nga sa më sipër kërkohet të kualifikohet oferta ekonomike pasi vendimi i dhënë nga KVO për këtë procedurë prokurimi është i padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

3. Përgjigje

Së pari: Konstatohet se ankesa datë 02.05.2023 e “OLSI” Sh.p.k është publikuar në databazën e të dhënave të ankesave në Komisionin e Prokurimit Publik në datën 26.04.2023 dhe është dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor në datë 02.05.2023 administruar me Nr. 142/13 Prot datë 02.05.2023 por rezulton që nuk është plotësuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe më konkretisht me nenin 94 pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Shtojcës 19 të DST.

Ankesës së paraqitur pranë institucionit tonë nuk i është bashkëlidhur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Autoritet kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik të korrigjojë ankesën sipas parashikimeve të nenit 94 pika 4 dhe 5 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Menjëherë është vënë në dijeni për këto ndryshime edhe Komisioni i Prokurimit Publik. Ankesa është korrigjuar nga operatori ekonomik sipas legjislacionit në fuqi në datën 09.05.2023. Pranë shoqërisë tonë është depozituar dokumenti bankar i cili vërteton pagesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ky dokument është administruar me Nr. 142/17 Prot datë 09.05.2023.

Së dyti: Në lidhje me pretendimin e “OLSI” Shpk se Autoriteti Kontraktor në vlerësimin e një procedure prokurimi dubet ti referohet vetëm ligjit 162 datë 23.12.2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, sqarojmë se aktet normative në fjalë edhe pse nuk janë ligj i posaçëm që rregullon punën e përditëshme të Autoriteteve Kontraktore ng fushën e prokurimit publik, janë akte ligjore që plotësojnë ligjin e posaçëm dhe nuk bien në kundërshtim me të. Akti Normativ Nr.5 date 12.03.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1996 dhe Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, dat 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar kanë dalë si pasojë e krijimit të një situate të veçantë e cila nuk ka egzistuar më parë dhe për aq kohë sa do të vazhdojë të ekzistojë kjo situatë e veçantë e shpallur me Vendim të Këshillit të Ministrave duhet të respektohen dhe të meren në konsideratë prej Autoriteteve Kontraktore dispozitat e tyre ligjore. Neni 4 i Aktit Normativ Nr. 8 datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar" citon shprehimisht se:..”7. Të gjitha institucionet shtetërore që zhvillojnë procedura prokurimi për produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, të përcaktuara në vendimin e Bordit, duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e këtij ligji, si dhe vendimet e Bordit për çmimet e miratuara të produkteve dhe nënprodukteve të naftës dhe gazit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së veçantë.”.

Në këtë frymë dhe në zbatim të sa sqaruam më lart Agjencia e Prokurimit Publik ka nxjertë Njoftimin nr. 2060, datë 23.03.2022 drejtuar Autoriteteve dhe Enteve Kontraktore ku sjell në vëmendje se duhet të mbahet në konsideratë Akti Normativ Nr.5 datë 12.03.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999. Si përfundim nga sa më sipër gjejmë me vënd dhe e konsiderojmë qëndrimin që ka mbajtur KVO të bazuar në ligj.

Së treti; Në lidhje me pretendimin e “OLSI” Sh.p.k se Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e ligjit Nr. 44/2022 "Për miratimin e Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar”, pra si përfundim operatori ekonomik pretendon se me këtë vendim Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka shfuqizuar Bordin e Transpaerncës sqarojmë se:

Autoriteti Koniraktor menjëhersh ka ndjekur rrugën ligjore duke verifikuar në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese ëëë.gjk.gov.al dhe ka kërkuar vendimin në fjalë, por rezulton se deri ditën kur është marrë ky vendim (Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesës) nuk ka asnjë publikim në lidhje me vendimin në fjalë.

Duke ju referuar nenit 132 në veçanti pikës 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i cili citon se: " Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër.”.

Pra edhe nëse pretendimi i operatorit ekonomik se Gjykata Kushtetuese ka marrë një vendim duke shfuqizuar ligjin Nr. 44/2022 "Për miratimin e Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" dhe duke shfuqizuar Bordin e Transapercës ky vendim nuk është botuar në Fletoren Zyriare dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik.

Autoriteti Kontraktor nuk ka asnjë mundësi të njihet me këtë vendim sidomos me pjesën arsyetuese të tij.

Në mbështetje të asaj që kemi argumentuar më sipër ju sjellim në vëmendje dhe Ligjin Nr. 8577 datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë?", të ndryshuar neni 76 Efektet Juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese i cili citon se: " Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrvëveshjet ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Si përfundim:

Mbështetur në konstatimet e arsyetimet e mësipërme, si dhe bazuar në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" nenin 114, pika 3, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, nenin 102, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës unanimisht

VENDOS:

1. Refuzimin e Ankesës të "OLSI" Sh.p.k dhe lënien në fuqi të Vendimit të KVO Nr.142/11 prot, datë 13.04.2023, për skualifikimin e "OLSI" Sh.p.k në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar" REF-REF-63921-03-28-2023, me objekt "Blerje gazoil" dhe fond limit 9.815.000 (nëntëmilion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë) leke pa TVSH,, të zhvilluar në datën 11.04.2023. ”.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, të ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “T&XH” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “- Lidhur me operatorin ekonomik “OLSI” Sh.p.k, mbështetur në nenin 92, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si dhe në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, nenin 82, vendos që ofertuesi “OLSI” Sh.p.k të moskualifikohet sepse : Oferta e “OLSI” Sh.p.k me marzh fitimi 16,2 lekë/litër është në kundërshtim me nenin 2 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar” , i cili përcakton marzhin e tregtimit me pakicë : 12 lekë/ litër. Referuar nenit 4 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, si dhe Njoftimit të APP-së nr. 2060, datë 23.03.2022 , si anëtar i KVO-së mbaj në konsideratë parashikimet e Ligjit Nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar dhe për shkak se marzhi i fitimit i ofuar është më i lartë se kufiri 12 lekë/ litër vendos që të mos pranoj ofertën e “OLSI” Sh.p.k.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, Seksioni 2: “Objekti i Kontratës”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: Blerje gazoil

III.1.2. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, Seksioni 4: “Procedura”, pika 4.3 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

4.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto**

Sipas rëndësisë:

çmimi pikët

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

OSE

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x**

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet kontraktore kur

sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

III.1.3. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, Seksioni: “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 4 “Formularët e tenderit dhe Listat Çmimeve”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

4. Formularët e tenderit dhe Listat Çmimeve Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

III.1.4. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, Seksioni II “LISTA E SHTOJCAVE”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 1/1. Formulari i

Ofertës.....

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimet

Shtojca 7. Formulari. i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

III.1.5. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, në pikën 2.1/c “**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**”, të Shtojcës 7 autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

c. Formularin e ofertes sipas Shtojcës 1/1.

III.1.6. Në shtojcën 1/1 “Formulari Ofertës” pjesë e dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 1/1

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: [shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike

dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.1.7. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "OLSI" SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër nga dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

Shtojcën 1/1 "Formulari i Ofertës", sipas të cilës shoqëria "OLSI" SHPK deklaron se çmimi i ofertës është si më poshtë:

1	2	3

Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit
	Gazoil DI	16.2 leke/liter

III.1.8. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.9. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rëndësi ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.10. Në nenin 45, pika 2.1, të VKM Nr. 285 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2.1 Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet, bazuar në:
a) çmimin e bursës, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftime Publike;
b) elementet fiskale;
c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.”.

III.1.11. Në nenin 21/5, “Metodologjia e llogaritjes së çmimit”, të Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, (ndryshuar me ligjet: nr.9218, datë 8.4.2004, nr.9574, datë 3.7.2006, nr. 12/2013, datë 14.2.2013, nr. 71/2014, datë 10.7.2014, me aktet normative nr.5, datë 12.3.20221 dhe nr. 8, datë 25.3.2022), parashikohet shprehimisht se:

“Bordi cakton çdo javë ose, kur e vlerëson të nevojshëm, në diskrecion të tij, çmimin tavan për shitjen për gazoilin, benzinën dhe gazin e lëngshëm të naftës, sipas metodologjisë së mëposhtme:
a) Çmimi i tregjeve ndërkombëtare të një dite pune më parë nga mbledhja e Bordit, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e lëvrimin FOB Med, për gazoilin e standardit SSH EN 590 2018 dhe benzinën e standardit SSH EN 228 2018. Për rastin e GLN-së (gaz i lëngshëm i naftës) çmimi përcaktohet sipas faturës së importimit të siguruar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë;

b) Çmimit të përcaktuar në shkronjën “a”, të këtij neni, i shtohet një vlerë “premio” sipas faturës së importimit të siguruar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë për gazoilin e standardit SSH EN 590 2018 dhe benzinën e standardit SSH EN 228 2018. Për gazin e lëngshëm të naftës, çmimi caktohet vetëm sipas shkronjës “a”, të këtij neni;

c) Totali i vlerës së përfutur sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, konvertohet në lekë sipas kursit fiks të shpallur nga Banka e Shqipërisë një ditë më parë;

ç) Vlerës së llogaritur në përputhje me shkronjën “c”, të këtij neni, i shtohet marzhi bruto 3 lekë/litri për shoqëritë e tregtimit me shumicë;

d) Mbi çmimin që rezulton sipas shkronjës “ç”, të këtij neni, shtohen detyrimet doganore: i. akcizë; ii. taksë qarkullimi; iii. taksë karboni; iv. TVSH në import; v. tarifë markimi dhe skanimi; dh) Vlera, që rezulton sipas shkronjës “d”, të këtij neni, përbën çmimin e shitjes me shumicë, i cili publikohet;

e) Mbi çmimin, që rezulton sipas shkronjës “dh”, të këtij neni, shtohet marzhi bruto i tregtimit me pakicë 12 lekë/litri;

ë) Vlera, që rezulton sipas shkronjës “e”, të këtij neni, përbën çmimin i cili duhet të shpallet në tabelën e shitjes me pakicë të karburanteve.”.

III.1.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor

përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.13. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, rezulton se në dokumentet e tenderit dhe konkretisht në kriterin kualifikues të pikës 2.1/c të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues për plotësimin e këtij kriteri kualifikues duhet që të dorëzojë Shtojcën 1/1 "Formulari i ofertës" të plotësuar dhe vulosur, duke deklaruar marzhin e fitimit të shprehur në vlerës absolute në vlerën leke për 1 (një) litër të produktit objekt-prokurimi. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues "OLSI" SHPK ka plotësuar dhe dorëzuar Shtojcën 1/1 "Formulari i ofertës" duke deklaruar marzhin e fitimit në vlerën 16.2 leke/litër.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave më datë 14.04.2023 ku argumenton se: " ... *Oferta e "OLSI" Sh.p.k me marzh fitimi 16,2 lekë/litër është në kundërshtim me nenin 2 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar* ", i cili përcakton marzhin e tregtimit me pakicë : 12 lekë/ litër. Referuar nenit 4 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar", si dhe Njoftimit të APP-së nr. 2060, datë 23.03.2022 , si anëtar i KVO-së mbaj në konsideratë parashikimet e Ligjit Nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar dhe për shkak se marzhi i fitimit i ofuar është më i lartë se kufiri 12 lekë/ litër vendos që të mos pranoj ofertën e "OLSI" Sh.p.k.", Komisioni i Prokurimit Publi gjykon se ky argumentim i autoritetit kontraktor nuk është i mbështetur në kriteret kualifikuese të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit, ku nga ana e entit prokurues është përcaktuar detyrimi i ofertuesve për të dorëzuar Shtojcën 1/1 të plotësuar dhe ku të jetë deklaruar marzhi i fitimit sipas përcaktimeve në këtë shtojcë dhe ku deklarimi i marzhit të fitimit në këtë procedurë prokurimi specifike është në vetvete edhe oferta ekonomike e operatorëve ekonomik pjesëmarrës sipas përcaktimeve të nenin 45, pika 2.1, të VKM Nr. 285 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ndërsa përsa i përket përcaktimeve të nenit 2 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, Komisioni gjykon se përcaktimet e këtij neni i referohen politikave që ndjek shteti për të mbrojtur popullsinë nga abuzimet në treg dhe në këtë rast përcaktimet e kësaj dispozite janë detyruese për Bordin e Transparencës në vprimtarinë e saj dhe nuk mund të përdoret për vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi dhe për më tepër që vetë operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e tregtimit të karburanteve nuk mund që të tregtojnë këto produkte me çmim më të lartë se çmimi i përcaktuar nga ana e Bordit të Transparencës.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për deklarinimin e ofertës ekonomike, por në tejkalim të tij. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “OLSI” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “OLSI” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-63921-03-28-2023, me objekt: “Blerje gazoil”, me fond limit 9.815.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A..
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “OLSI” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “OLSI” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

